



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.157 dt.14.12.2001

**MBI
MIRATIM DHENIE AMBIENTI**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, dt.31.07.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Ligjit Nr.8626 dt.22.06.2000 “PER STATUSIN E INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK”, neni 14 pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve njerëzore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë

V E N D O S I

1. Të miratojë dhënien në përdorim pa kundërshtim për Shoqatën e Paraplegjikëve të Shqipërisë, të një ambienti me sipërfaqje 220 m2, sipas gentplanit bashkëlidhur për një periudhë 2 vjeçare
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike dhe Ndërmarrja Metalike Tirana
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

